



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË**



Përmbledhje

**E MBLEDHJES SË PESTË TË KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË
PAGESAVE (KKSP)**

e cila u mbajt

të martën, datë 1 Tetor 2019, nga ora 09:00 deri 14.30 në ambientet
e Bankës së Shqipërisë

Në datën 1 Tetor 2019, u zhvillua mbledhja e Pestë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), e cila u hap dhe u drejtua nga Kryetarja e këtij Komiteti Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë.

Mbledhja nisi me fjalën e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko, dhe Ministres së Financave dhe Ekonomisë, Zj. Anila Denaj. Në fjalën e tij, Guvernatori shprehu rëndësinë e rolit të Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave, si një entitet me karakter strategjik, konsultues dhe komunikues, në reformat e ndërmarra në fushën e sistemeve të pagesave dhe ndikimin e tyre në mbarëvajtjen e ekonomisë së vendit. Guvernatori theksoi se zbatimi i këtyre reformave kthen në domosdoshmëri bashkëpunimin ndërmjet aktorëve publikë dhe atyre privatë të tregut. Z. Sejko u ndal në rezultatet e deritanishme të KKSP-së, më i rëndësishmi prej të cilëve vlerësohet të jetë miratimi i Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël nëpërmjet të cilës synohet të modernizohet tregu me qëllim ofrimin e një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh të pagesave në mënyrë që të përmbushen nevojat e përdoruesve të tyre në rang vendi. Guvernatori theksoi se në kuadër të kësaj strategjie, Banka e Shqipërisë ka hartuar projektligjin “Për shërbimet e pagesave”, i cili synon stimulimin e përdorimit të instrumenteve elektronikë të pagesave nga publiku, uljen e kostos së tyre dhe rrjedhimisht uljen e përdorimit të parasë fizike (cash-it) në ekonomi. Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori Sejko u shpreh se zbatimi i këtyre nismave të rëndësishme kërkon dhe një publik të mirë informuar. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë e gjykon si të domosdoshme hartimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar të Publikut, e cila vlerësohet të sjellë përfitime të shumta në zgjerimin e përfshirjes financiare dhe thellimin e edukimit financiar.

Mbledhja vijoi me fjalimin e Ministres Zj. Denaj, e cila u fokusua në angazhimin e qeverisë për të luftuar informalitetin në ekonomi, përmes reformave dhe masave të ndryshme, duke vënë theksin tek projektligji i ri për Fiskalizimin, i cili u lançua për konsultim publik në muajin gusht. Në fjalimin e saj Zj. Denaj theksoi se qëllimi kryesor i këtij projekti është të luftojë evazionin fiskal nëpërmjet një legjislacioni të shëndetshëm, pajisjeve teknologjike dhe informacionit të përfutur në kohë reale për çdo transaksion të kryer në vend. “Ky ligj synon krijimin e një sistemi të ri faturimi dhe monitorimi të transaksioneve të bizneseve në vend, bazuar në një sistem të ri të pajisjeve fiskale”, u shpreh Ministria.

Pas fjalimeve përshëndetëse, mbledhja vijoi me diskutime të karakterit teknik duke u fokusuar në zhvillimet më të fundit ligjore e rregullative. Ky seksion u hap nga kryetarja e KKSP e cila pasi ritheksoi edhe njëherë bashkërendimin e përpjekjeve midis Bankës së Shqipërisë nëpërmjet ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nëpërmjet atij të “fiskalizimit”, ia dha fjalën Drejtoreshës së Përgjithshme e Tatimeve, Zj. Delina Ibrahimaj.

Në fjalën e saj Zj. Ibrahimaj solli detaje mbi projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, si dhe disa nisma të tjera të ndërmarra nga administrata tatimore në lidhje me rritjen e efikasitetit të procedurave fiskale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial në këtë drejtim. Në këtë kuadër, Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve theksoi se për mirëfunksionimin e këtyre nismave parashikohet si i nevojshëm dhe krijimi i një regjistri kombëtar për llogaritë bankare si dhe mundësia e aksesit në regjistrin e kredive. Nevoja e krijimit të një regjistri qendror për llogaritë bankare u nënvizua dhe nga Zj. Najada Xhaxha, përfaqësuese e Shoqatës Shqiptare të Bankave në Komitet si dhe përfaqësues të tjerë të bankave të cilët sollën eksperiencën e vendeve të tjera të rajonit ku ato operojnë.

Në vazhdim Z. Holti Banka, ekspert i Bankës Botërore mbajti një prezantim mbi analizën e pagesave qeveritare dhe nevojave për ndërhyrje në kuadër të automatizimit dhe digjitalizimit. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të tij u fokusuan në sektorin e pagave të institucioneve publike, pensionet dhe ndihmat sociale. Në këtë linjë, theksohet si i nevojshëm kanalizimi i këtyre pagesave nëpërmjet bankave si dhe analizimi i mundësive për kanalizimin e pagesave të Institucionit të Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë me qëllim optimizimin e proceseve dhe reduktimin e përdorimit të parasë fizike. Gjithashtu, një ndërhyrje e nevojshme në periudhën afatshkurtër-afatmesme është dhe operacionalizimi i një *payroll* të centralizuar për institucionet shtetërore bazuar në zhvillimet ekzistuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike.

Nevoja e operacionalizimit të *payroll*-it kombëtar si dhe skemave të tjera kombëtare si Debitimi Direkt u mbështetën edhe nga Zj. Xhaxha si dhe përfaqësues të tjerë të sistemit bankar në kuadër të rritjes së efikasitetit të tregut edhe nxitjes së konkurrencës.

Në lidhje me këtë çështje u shpreh edhe Zj. Nevila Repishti nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), e cila shpjegoi se AKSHI është përfshirë gjithashtu në projektin e operacionalizimit të *payroll*-it të Administratës Publike dhe pritet që në periudhën afatshkurtër të kemi zhvillime në këtë drejtim. Me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të platformës *e-Albania* u diskutua edhe mundësia e unifikimit të kontratës së nënshkruar nga institucionet pjesëmarrëse si dhe nevojat për ndërhyrje në këtë drejtim.

Seksioni i parë përfundoi me prezantimin e Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes pranë Bankës së Shqipërisë, Z. Deniz Deralla mbi ndryshimet ligjore/rregullative të nevojshme për hapjen e llogarive në distancë. Z. Deralla shpjegoi se bazuar në rishikimet e fundit të legjislacionit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, si dhe zhvillimeve të tregut, Banka e Shqipërisë është duke punuar për rishikimin e kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë. Në mbështetje të kësaj nisme të Bankës së Shqipërisë, ekspertja e Bankës Botërore, Zj. Maria Do Ceu Da Silva Pereira prezantoi zhvillimet ndërkombëtare duke u fokusuar kryesisht në ato evropiane në lidhje me identifikimin elektronik të klientëve në distancë.

Në konkluzionet e nxjerra nga ky seksion Zj. Minxhozi propozoi krijimin e një grupi pune për mbështetjen e digjitalizimit dhe automatizimit të pagesave qeveritare bazuar edhe në gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara nga studimi i Bankës Botërore.

Mbledhja e V^{të} e KKSP-së vazhdoi me një seksion me temë “*Masa të nevojshme për reduktimin e cash-it dhe informalitetit*”. Në këtë drejtim, Z. Marek Rozkrut, përfaqësues i Ernst&Young prezantoi një studim me temë “Reduktimi i ekonomisë informale në Shqipëri nëpërmjet përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave”. Studimi kishte për qëllim matjen sasiore të ekonomisë informale dhe identifikimin e kostove që mbart ekonomia shqiptare nga ky fenomen. Gjithashtu, studimi parashikonte dhe sugjerime në lidhje me promovimin e pagesave elektronike në ekonominë shqiptare duke synuar reduktimin e informalitetit në këtë drejtim duke propozuar incentiva për aktorë të ndryshëm ekonomikë. Gjithashtu, duke qenë se një komponent i rëndësishëm i mekanizmave incentivues lidheshin me lehtësimet

fiskale, studimi parashikonte skenarë në lidhje me kostot e qeverisë në periudhën afatshkurtër dhe përfitime në periudhën afatgjatë. Në përfundim të prezantimit të Z. Rozkrut, fjalën e morën ekspertët e Bankës Botërore, Zj. Maria Do Ceu Da Silva Pereira, e cila duke njohur më mirë kontekstin shqiptar nga eksperiencia disa vjeçare e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë propozoi përshtatjen e disa rekomandimeve me kontekstin shqiptar. Gjithashtu, në vijim fjalën e mori Z. Holti Banka, i cili si autor kryesor i studimit të kostove të instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri bëri disa sugjerime për mënyrën e matjes së kostove të instrumenteve të pagesave dhe *cash-it* duke paraqitur kështu një anë tjetër të kostove që mbartin këto instrumente në ekonominë shqiptare në tërësi.

Ky seksion vijoi me prezantimin e Zj. Ledia Bregu, Drejtor, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës pranë Bankës së Shqipërisë mbi studimin e kostove të transaksioneve me kartë në Shqipëri dhe nevojave për ndërhyrje. Gjatë prezantimit të saj Zj. Bregu theksoi se nga analizimi i deritanishëm rezultoi se tregu i pagesave me kartë reflektohet me një aktivitet të limituar duke reflektuar një numër të ulët të popullsisë shqiptare që zotëron karta bankare dhe i përdor ato si një mjet pagese. Ky zhvillim përtej faktorëve të tjerë si edukimi dhe përfshirja financiare lidhet edhe me një zhvillim të limituar të infrastrukturës së pranimit të këtyre kartave në tregun shqiptar (zotërimi i POS-ve nga tregtarët). Në vijim Zj. Bregu theksoi se rezultatet e analizës së kostove që mbartin tregtarët shqiptarë nga pranimi i pagesave me kartë rezultoi shumë i lartë, gjithashtu edhe *interchange fees* dhe kostot e procesimit si komponent përbërës janë të larta krahasuar me praktikën evropiane. Për sa më sipër, u theksua nevoja për një analizim më të thelluar të alternativave për ndërhyrje.

Në përfundim të këtij prezantimi, përfaqësues të bankave argumentuan që janë të vetëdijshëm për mungesën e efikasitetit të tregut të kartave, megjithatë vlerësuan se këto zhvillime ndikohen edhe nga faktorë të tjerë përtej kostove të tregtarëve.

Duke vlerësuar këto diskutime Kryetarja e Komitetit propozoi ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e kostove të kartave në tregun shqiptar dhe evidentimin e nevojave për ndërhyrje me qëllim rritjen e efikasitetit të këtij instrumenti dhe si rrjedhojë përdorimin e tyre në ekonominë shqiptare.

Seksioni i dytë i mbledhjes përfundoi me një ndërhyrje të Zj. Nevila Repishti mbi zhvillimet më të fundit të AKSHI-t, si një institucion kyç në digjitalizimin e shërbimeve qeveritare, por edhe nga pikëpamja e shërbimeve që ofron ky institucion për zbatimin e firmës elektronike.

Seksioni i tretë i mbledhjes së KKSP vijoi me diskutime e prezantime në lidhje me zhvillimet më të fundit në fushën e Edukimit Financiar. Ky seksion u hap nga kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave (SHSHB), Z. Silvio Pedrazzi, i cili theksoi kontributin e deritanishëm të sistemit bankar në edukimin financiar. Megjithatë, Z. Pedrazzi nënvizoi se është e nevojshme që në këtë drejtim të ketë një kontribut të gjerë nga të gjithë aktorët. Gjithashtu, kryetari i SHSHB konfirmoi angazhimin e sistemit bankar në këto nisma kombëtare.

Seksioni i edukimit financiar vijoi me një prezantim të Z. Altin Tanku, i cili risolli në vëmendje të pjesëmarrësve rëndësinë që ka edukimi financiar i popullsisë si dhe bëri një përmbledhje të masave të ndërmarra nga ana e Bankës së Shqipërisë në këtë fushë.

Në përfundim të këtij sesi, Zj. Edlira Dashi, eksperte e Bankës Botërore prezantoi eksperiencën dhe rezultatet e projektit *Greenback 2.0* në qytetin e Beratit.

Në konkluzionet e këtij seksioni Kryetarja e KKSP, Zj. Minxhozi theksoi rëndësinë e edukimit financiar në kuadër të arritjes së objektivave të synuar së reformave të ndërmarra në fushën e pagesave dhe më gjerë. Në këtë kuadër Zj. Minxhozi theksoi nevojën e hartimit të një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar si dhe nënvizoi nevojën e bashkërendimit të veprimeve të gjithë aktorëve. Për këtë

qëllim, Zj. Minxhozi propozoi krijimin e një *Task Force* me përbërje gjithëpërfshirëse për hartimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar.

Në përfundim të mbledhjes, duke u bazuar në diskutimet e gjeneruara gjatë seksioneve, Kryetarja e Komitetit rekomandoi krijimin e disa grupeve të punës, me qëllim marrjen e masave konkrete mbi çështjet e ngritura në mbledhje, në lidhje me edukimin financiar, digjitalizimin e pagesave të qeverisë, si dhe analizimin e kostove të pagesave me karta në tregun shqiptar.

Në mbështetje të objektivit strategjik të këtij Komiteti për modernizimin e pagesave me vlerë të vogël, mbledhja e V-të përfundoi me një seksion të posaçëm, ku aktorë të ndryshëm të tregut prezantuan disa nga nismat më të fundit në tregun e pagesave.

Rekomandimet e mbledhjes së pestë të Komitetit Kombëtarë të Sistemit të Pagesave.

Krijimi dhe zbatimi i objektivave të parashikuara në strategji në lidhje me krijimin e një:

- a) *Task Force* me përbërje gjithëpërfshirëse për hartimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar.
- b) Grup Pune në mbështetje të digjitalizimit dhe automatizimit të mëtejshëm të pagesave qeveritare bazuar edhe në gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara nga studimi i Bankës Botërore.
- c) Grup Pune me qëllim analizimin e kostove të kartave në tregun shqiptar dhe evidentimin e nevojave për ndërhyrje me qëllim rritjen e efikasitetit të këtij instrumenti dhe si rrjedhojë përdorimin e tyre në ekonominë shqiptare.

Pjesëmarrja në mbledhje.

Të Ftuar në Mbledhjen e Pestë e KKSP		
Institucioni	Emri i Anëtarit	Pozicioni
Banka e Shqipërisë	Z. Gent Sejko	Guvernator
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zj. Anila Denaj	Ministër
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Zj. Delina Ibrahimaj	Drejtor i Përgjithshëm
Banka e Shqipërisë	Z. Altin Tanku	Drejtor i Departamentit të Kërkimeve
Banka Botërore	Zj. Maria Do Ceu Da Silva Pereira,	
Banka Botërore	Z. Holti Banka,	
Banka Botërore	Zj. Edlira Dashi	
Mastercard	Zj. Silvia Hadzhiyaneva	
Ernst & Young	Z. Marek Rozkrut, Zj. Anisa Jasini	

Anëtarët e KKSP në Mbledhjen e Pestë			

Institucioni	Emri i Anëtarit	Statusi në KKSP	Përfaqësuar në rast mungese
Banka e Shqipërisë	Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë	Kryetare	
Shoqata Shqiptare e Bankave	Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave	Anëtar	
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Zj. Mirlinda Karcanaj, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Nevila Repishti
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv	Anëtar	Zt. Niko Kotonika Zj. Fjoralba Soukis Zj. Ornela Kullolli
Banka e Shqipërisë	Zj. Ledia Bregu, Drejtor, DSPKF	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Deniz Deralla, Drejtor, Departamenti i Mbikëqyrjes	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Donald Duraj, Shefi i Kabinetit	Anëtar	
Shoqata Shqiptare e Bankave	Zj. Najada Xhaxha, Kryetare e Komitetit të Pagesave pranë SHSHB	Anëtar	
Paylink	Zj. Eneida Thomaj, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Z. Admirim Ymeri
Unioni Financiar	Z. Elton Çollaku, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	
Easy Pay	Zj. Linda Shomo Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Stela Shkodrani
MPay	Z. Ludovic Laventure, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Erinda Kapllani, Zj. Elda Kuka
AK-Invest	Z. Ilir Adili Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Odeta Ferro, Z. Geis Ceku
Shoqata Shqiptare e Bankave	Z. Spiro Brumbulli	Sekretariat	Zj. Junida Katroshi Zj. Eftali Peçi
Banka e Shqipërisë	Zj. Valentina Semi DSPKF	Sekretariat	
Pjesëmarrës të Tjerë			
Helvetas	Z. Andi Stefanllari		
Procredit Bank	Zj. Enkeleda Gremshi, Zj. Akile Cernobregu		
Raiffeisen Bank	Z. Almir Zeneli, Zj. Eltjona Gjonedaj Z. Arian Berberi		
OTP Bank	Z. Ardian Hasa, Z. Igli Kasneci		

UBA Bank	Z. Ermal Husha, Z. Ardian Guza, Zj. Tereza Brakaj		
Alpha Bank	Z. Ilir Prifti		
Fibank	Zj. Elma Lloja, Zj. Ines Vucini		
Union Bank	Zj. Suela Bokshi		
Credins Bank	Z. Dimitri Toslluku, Zj. Suela Cela		
Tirana Bank	Z. Bledar Kumanova		
ABI Bank	Zj. Brunilda Jakovi, Zj. Odeta Paloka, Zj. Majlinda Miho		
Banka e Shqipërisë	Z. Valer Miho, Zj. Edlira Hoxha, Zj. Armida Isakaj, Zj. Arlinda Kolenico		